

"MAG UTILITIES" shpk

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Së bashku me raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7– 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakun e Shoqërisë Mag Utilities sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Mag Utilities sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datën 31 dhjetor 2019, Pasqyrën e Performancës, Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare dhe Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për Pasqyrat Financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

28 dhjetor 2020

Luan Kamberi
Auditues Ligjor



"MAG UTILITIES" shpk

Pasqyrat financiare me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	5	664,239	2,186,289
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	22,064,584	21,573,041
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	5,849,036	3,526,021
Inventari	8	11,170,303	12,078,576
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	4,183,124	3,427,692
Total aktive afatshkurtra		43,931,286	42,791,619
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	24,915,609	30,311,430
Aktive afatgjatë jomateriale	11	1,951,869	2,298,427
Total aktive afatgjatë		26,867,478	32,609,857
Total aktive		70,798,764	75,401,476
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	23,200,073	28,103,949
Detyrime tatimore	13	679,050	1,123,754
Të ardhurat e shtyra	14	7,001,664	7,001,664
Hua afatshkurtra	15	4,655,594	-
Të tjera detyrime	16	17,132,775	15,059,751
Total detyrime afatshkurtra		52,669,156	51,289,118
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	17	13,023,782	19,020,879
Total detyrime afatgjatë		13,023,782	19,020,879
Totali i detyrimeve		65,692,938	70,309,997
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	18	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		4,981,479	4,899,293
Fitimi i ushtrimit		14,347	82,186
Total kapitali		5,105,826	5,091,479
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		70,798,764	75,401,476

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"MAG UTILITIES" shpk
Pasqyrat financiare me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës Financiare
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	105,320,911	115,013,848
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	123,433	2,097,127
Lënda e pare, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(69,659,290)	(82,360,197)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	21	(65,904,697)	(74,972,322)
2) Të tjera shpenzime	22	(3,754,593)	(7,387,875)
Shpenzime të personelit	23	(27,794,455)	(26,704,469)
1) Paga dhe shpërblime		(23,832,152)	(22,941,716)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shendetësore		(3,962,303)	(3,762,753)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10/11	(6,497,020)	(7,843,235)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(99,516)	(18,629)
Shpenzime/Të ardhura financiare neto	25	(1,128,141)	153
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,222,282)	(1,484,584)
2) Shpenzime/të ardhura të tjera financiare neto		94,141	1,484,737
Fitimi para tatimit		265,922	184,598
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(251,575)	(102,412)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(251,575)	(102,412)
Fitimi i vitit		14,347	82,186
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		14,347	82,186

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"MAG UTILITIES" shpk
 Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2018	100,000	10,000	2,562,472	2,336,821	5,009,293
Fitimi / Humbja e vitit				82,186	82,186
Lëvizjet përmes kapitalit			2,336,821	(2,336,821)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	10,000	4,899,293	82,186	5,091,479
Fitimi / Humbja e vitit				14,347	14,347
Lëvizjet përmes kapitalit			82,186	(82,186)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	10,000	4,981,479	14,347	5,105,826

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar dhe firmosur si më poshtë:

Rigëris Kasneci

Rigëris Kasneci
 Administrator

Mazars shpk
 Mazars shpk

Mazars shpk
 Rr. Emip Duraku, Pall. "Banjaket",
 No.5, 1003, Tirana, Albania
 Phone: +355 42 27 80 15
 www.mazars.al, info@mazars.al



"MAG UTILITIES" shpk
Pasqyrat financiare me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi i vitit	14,347	82,186
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(123,433)	(2,097,127)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,497,020	7,843,235
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(3,569,990)	12,393,981
Rënie/(rritje) në inventarë	908,273	(5,118,062)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,560,819	(1,288,599)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	5,287,036	11,815,614
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(754,641)	(3,653,778)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(754,641)	(3,653,778)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	(5,997,097)	(7,406,196)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(5,997,097)	(7,406,196)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(1,464,702)	755,640
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,186,289	1,439,846
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(57,348)	(9,197)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	664,239	2,186,289

5

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "MAG UTILITIES" Shpk është regjistruar pranë QKR-së më datë 30/12/2015 me NIPT L52430023N.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti i saj.

Selia e shoqërisë ndodhet në: Blloku rezidencial "Kodra e Diellit", Tiranë.

Kapitali i shoqërisë "MAG UTILITIES" Shpk është 100,000 Lekë, i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 Lekë.

"MAG UTILITIES" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortak të vetëm Z. Gazmend Metohu.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: Transport urban, interurban dhe ndërkombëtar për pasagjerë dhe mallra për të tretë dhe për nevojat e shoqërisë. Tregtim dhe import automjeteve të ndryshme, autovetura, autobuzë, kamionë etj, lubrifikantë pjesë këmbimi për automjete, goma, etj. Agjensi transporti udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit. Park dhe oficinë riparimi automjeteve, autovetura, autobuzë, kamione etj. shërbime pastrimi qendrash rezidenciale, qytetesh, ndërtesash tregtare dhe banimi, godinash industriale, kanalizimesh të ujrave të bardha e të zeza, sipërfaqesh të gjelbra, rrugëve, etj. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të makinave, makinerive dhe pasjisjeve për të gjitha llojet e pastrimeve, etj. Import/Eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të lëndëve dhe substancave që shërbejnë për të gjitha llojet e kategoritë e shërbimeve të pastrimit, etj. Aktivitetet dhe veprimtaritë e komisionit dhe agjencisë si dhe konsulencë në fushën e pastrimit të të gjitha llojeve, përfaqësime dhe transaksione; Prodhim dhe tregtim i të gjitha llojeve të kontenitoreve, kazanëve, kapakët e pusetave, zgarave, apo materialeve të tjera, etj. Aktivitet në fushën e ndërtimit dhe punimeve civile. Aktivitet në impiantet e grumbullimit, riciklimit, trajtimit të mbetjeve urbane, etj. Aktivitet në fushën e sinjalistikës rrugore, prodhim dhe shitje tabelash sinjalistike, cdo aktivitet tjetër, i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo që ka lidhje me aktivitetet e sipërpërmendura, i cili konsiderohet fitimprurës nga organet administruese të shoqërisë; aktivitet në fushën e import-export të materialialeve të ndryshme.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 42. (2018: 47).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" hyrë në fuqi në 1 Janar 2019, si dhe shënimeve shpjeguese të aplikueshme në përputhje me nenin 16 të ligjit të sipërpërmendur.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

"MAG UTILITIES" shpk
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Euro/LEK	121,77	123,42
USD/ LEK	108.64	107,82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

“MAG UTILITIES” shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlera e mbetur	20%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	345,209	2,050,473
Llogari rrjedhëse	345,209	2,050,473
Mjete monetare në arkë	319,030	135,816
	664,239	2,186,289

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	22,064,584	21,573,041
	22,064,584	21,573,041

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH e kreditueshme	2,461,293	-
Garanci të paguara	45,000	45,000
Detyrime doganore	61,364	23,421
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	2,834,966	2,815,013
Tatim fitimi	446,413	642,587
	<u>5,849,036</u>	<u>3,526,021</u>

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lendë të para dhe materiale	2,290,572	3,833,728
Mallra për rishitje	8,879,731	8,244,848
	<u>11,170,303</u>	<u>12,078,576</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime	-	40,162
Shpenzime për t'u shpërndarë	4,183,124	3,387,530
	<u>4,183,124</u>	<u>3,427,692</u>

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Mjete Transporti	Makinieri dhe pajisje	Mobilije zyre	Instrumenta Vegla pune	Pajisje Informative	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	41,211,700	1,744,186	28,210	204,167	281,027	1,512,971	44,982,261
Shtesa	-	-	27,097	-	75,869	1,024,072	1,127,038
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	41,211,700	1,744,186	55,307	204,167	356,896	2,537,043	46,109,299
Shtesa	737,100	-	-	-	17,541	-	754,641
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	41,948,800	1,744,186	55,307	204,167	374,437	2,537,043	46,863,940
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2018	7,537,795	441,860	12,472	37,084	50,500	170,335	8,250,046
Amortizimi i vitit	6,734,781	260,465	15,230	33,417	85,596	418,334	7,547,823
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	14,272,576	702,325	27,702	70,501	136,096	588,669	15,797,869
Amortizimi i vitit	5,461,535	208,372	5,521	26,733	58,626	389,675	6,150,462
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	19,734,111	910,697	33,223	97,234	194,722	978,344	21,948,331
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	26,939,124	1,041,861	27,605	133,666	220,800	1,948,374	30,311,430
Gjendja më 31 dhjetor 2019	22,214,689	833,489	22,084	106,933	179,715	1,558,699	24,915,609

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM	Total
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,599,883	2,599,883
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,599,883	2,599,883
Amortizimi		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	301,456	301,456
Amortizimi i vitit	346,558	346,558
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	648,014	648,014
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,298,427	2,298,427
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,951,869	1,951,869

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë vendas	19,706,272	24,352,953
Furnitorë të huaj	3,493,801	3,750,996
	23,200,073	28,103,949

13. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	540,406	521,475
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	102,807	92,183
Tatim në burim	35,837	22,169
TVSH për t'u paguar	-	487,927
	679,050	1,123,754

"MAG UTILITIES" shpk**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***14. Të ardhurat e shtyra**

Te ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime nga klientë	7,001,664	7,001,664
	<u>7,001,664</u>	<u>7,001,664</u>

15. Hua afashtkurtra

Hua afashtkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Overdraft EUR	4,655,050	-
Overdraft USD	544	-
	<u>4,655,594</u>	<u>-</u>

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime nga personeli	928,307	28,600
Të tjera detyrime	16,204,468	15,031,151
	<u>17,132,775</u>	<u>15,059,751</u>

17. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Qira financiare	13,023,782	19,020,879
	<u>13,023,782</u>	<u>19,020,879</u>

18. Kapitali

Më 31 dhjetor 2019 kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100,000 LEK, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 LEK.

"MAG UTILITIES" shpk**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	100,155,218	108,245,403
Të ardhura nga shërbimet	5,165,693	6,768,445
	<u>105,320,911</u>	<u>115,013,848</u>

20. Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar balanca e së cilave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(3,453,661)	(959,676)
Fitime nga këmbimit valutore	3,577,094	3,056,803
	<u>123,433</u>	<u>2,097,127</u>

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Kosto e mallrave të shitur	13,432,487	20,658,123
Materiale ndihmëse	6,315,135	4,266,946
Lëndë djegese	35,506,045	37,817,298
Energji elektike	360,672	407,490
Mirëmbajtje dhe riparime mjetet	1,814,430	2,279,258
Prime sigurimi	1,535,627	1,301,537
Shpenzime Uji	139,783	319,156
Nënkontraktorë	-	7,705
Transport	767,040	655,564
Shërbime marketingu	3,861,956	1,403,822
Shërbim roje	1,409,747	1,356,958
Qira	630,999	4,388,711
Të tjera	130,776	109,754
	<u>65,904,697</u>	<u>74,972,322</u>

"MAG UTILITIES" shpk**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***22. Të tjera shpenzime**

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime administrative dhe noteriale	78,529	12,241
Konsulenca ekonomike dhe juridike	942,238	815,820
Shërbime nga të tretë	80,600	4,500,000
Blerje të ndryshme, kancelari etj	145,497	198,867
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	372,160	337,473
Prime sigurimi	271,540	-
Komisione bankare	171,454	123,924
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	212,882	1,150
Taksa të ndryshme	307,337	687,656
Shpenzime për pritje dhe dhurata	48,420	77,135
Shpenzime të tjera	1,123,936	629,589
Reklama, publicitet	-	4,020
	<u>3,754,593</u>	<u>7,387,875</u>

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	23,832,152	22,941,716
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,962,303	3,762,753
	<u>27,794,455</u>	<u>26,704,469</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqesin gjobat dhe penalitetet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoba dhe penalitete	99,516	18,629
	<u>99,516</u>	<u>18,629</u>

"MAG UTILITIES" shpk**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***25. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për interesa	(1,222,282)	(1,484,584)
Të ardhura të tjera financiare	94,141	1,484,737
	<u>(1,128,141)</u>	<u>153</u>

26. Shpenzimi i tatim mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitimi para tatimit	265,922	184,598
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	1,411,244	498,152
Shpenzime pritje dhe percjellje, dhurata	465,922	77,135
Shpenzime udhëtimi	236,236	4,941
Penalitet, gjoha e dëmshpërblime	-	60,434
Shpenzime të tjera	709,086	355,642
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	1,677,166	682,750
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi 15%	251,575	102,412
Fitimi neto	14,347	82,186

27. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2019, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

"MAG UTILITIES" shpk

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

28. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

